

HAMIT KABA

POLITIKA E PERËNDIMIT¹ NDAJ SHQIPËRISË GJATË KRIZËS SHQIPTARO-SOVJETIKE

Konflikti shqiptaro-sovjetik i viteve 1960-1961 është trajtuar nga studiues të ndryshëm, ku spikasin ata perëndimorë.² Dëshira e mirë për të ndriçuar të vërtetën dhe burimet e nevojshme arkivore mbi këtë subjekt, ishte një shtysë e mjaftueshme për të shkruar këtë artikull. Konflikti shqiptaro-sovjetik i vitit 1960-1961 ishte çarja tjetër e radhës, pas asaj që kishte ndodhur me Jugosllavinë në vitin 1948. Kjo ngjarje u njoh dhe u përdor nga Perëndimi, në funksion të nxitjes dhe thellimit të kontradiktave brenda Bllokut Sovjetik, i cili nuk ishte më monolit si më parë dhe Lëvizjes Komuniste Ndërkombëtare.

Përmes këtij artikulli unë do të përpiqem t'u jap përgjigje pyetjeve në vijim: Si e perceptuan shtetet perëndimore dhe veçanërisht SHBA, krizën shqiptaro-sovjetike dhe si e shfrytëzuan atë në favor të luftës së tyre kundër Bllokut Komunist? Ç'rol ka luajtur NATO gjatë konfliktit dhe si ndihmuan SHBA në harmonizimin e qëndrimeve të shteteve perëndimore ndaj Shqipërisë? Pse SHBA, Britania e Madhe dhe të tjerë shtete perëndimore nuk arritën të rivendosnin marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë? Pse bota perëndimore e vlerësoi dhe trajtoi konfliktin shqiptaro-sovjetik të vitit 1961, ndryshe nga konflikti sovjeto-jugosllav i vitit 1948 etj.?

Sfondi i konfliktit shqiptaro-sovjetik

Ardhja në pushtet e pasardhësve të Stalinit pas vdekjes së tij dhe në veçanti e Hrushovit, u shoqërua me ndryshime të rëndësishme, të cilat

¹ Koncepti "Perëndim dhe vende perëndimore" përdoret në kontekstin e Luftës së Ftohtë. Ai nuk përputhet plotësisht me kriterin gjeografik dhe kulturor. Përdorimi i tij në rastin konkret ka të bëjë me kriteret ideologjike, politike dhe ushtarake. Në këtë kuptim, në grupin e vendeve perëndimore kemi përfshirë edhe shtete të tilla si: Greqia e Turqia, të cilat nuk janë pjesë e Perëndimit të sotëm. Në kohën e Luftës së Ftohtë këto dy shtete ballkanike ishin pjesë e strukturave politike dhe ushtarake të vendeve perëndimore.

² Shih: William E. Griffith, *Albania and the Sino-Soviet Rift*, Massachusetts: The M.I.T. Press, Cambridge, 1963; Zbigniew K. Brzezinski, *The Soviet Bloc Unity and Conflict*, Massachusetts: Harvard University Press, Cambridge, 1967; Nicholas C. Pano, *The Peoples Republic of Albania*, Maryland: The Johns Hopkins Press, 1968, etc.

ndikuan mbi zhvillimet e ardhshme të BRSS dhe të Kampit Socialist. Idetë e Hrushovit të paraqitura në Kongresin XX-të të PKBS dhe lufta kundër kultit të individit të Stalinit e shkatërruan imazhin e tij, dhe i ofruan botës komuniste idenë e shkuarjes në komunizëm përmes rrugëve kombëtare dhe të konkurrencës me Perëndimin. Ideja e rrugëve të ndryshme për të shkuar në socializëm, ndryshe të njohura si “adaptim kombëtar i m-l”³, do të ngjallnin shpresa për ndryshime në vendet e Bllokut Komunist. Idetë e Kongresit XX-të u reflektuan në nivele të ndryshme në vendet socialiste të Evropës Lindore. Por, udhëheqja shqiptare ishte më e rezervuar ndaj tyre. Ajo u gjend e papërgatitur, e befasuar dhe e rrezikuar nga vendimet e tij dhe veçanërisht nga raporti sekret i Hrushovit, i cili iu bë prezent udhëheqësve më të lartë pjesëmarrës në Kongresin e 20, disa ditë pas fillimit të tij. Sidoqoftë, udhëheqësit kryesorë të PPSH, Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu, i pranuan formalisht dhe pa ndonjë entuziazëm vendimet e Kongresit XX. Këtë gjykim e krijon pas leximit të fjalimit të Enver Hoxhës, të mbajtur më 18 shkurt 1956 në Kongresin XX-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik⁴ në Moskë dhe sidomos pas njohjes me shënimet e mbajtura prej tij disa ditë më pas, pasi ai u njoh me raportin sekret të Hrushovit, më 26 shkurt 1956. Enver Hoxha do të shkruante në ditarin e vet: “Për tërë natën lexova një raport sekret të N. Hrushovit, që na u dha edhe neve, si të gjithë delegacioneve të tjera të huaja. Raporti hedh poshtë figurën dhe veprën e madhe të Stalinit. E ndjeva qëndrimin e Hrushovit me shokë ndaj Stalinit dhe veprës së tij të lavdishme që gjatë punimeve të Kongresit, ku emri i tij nuk u përmend asnjëherë për të mirë, po se arrinin deri këtu nuk ma merrte mendja”.⁵

Dënimi i kultit të individit të Stalinit do të prekte disa më vonë edhe figurën e Enver Hoxhës dhe do t'i hapte rrugën një procesi kritikash ndaj tij dhe udhëheqjes më të lartë të PPSH, të cilët ishin ideatorët dhe përgjegjësit kryesorë për zhvillimet në Shqipërinë e pas Luftës së Dytë Botërore. Këtë frymë e dëshmoi qartë Konferenca e Partisë së Tiranës, e

³ Kurt L. London, “Eastern Europe in the Communist World”, *The United States and Eastern Europe*, The American Assembly, Columbia University, Prentice-Hall, Inc., Englewood Cliffs, N.J. p. 108.

⁴ *Zëri i Popullit*, organ i KQ të PPSH, viti XII nr. 43 (2312), 19 shkurt 1956; Enver Hoxha, *Ditar 1955-1957*, Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, 1987, f. 123.

⁵ E. Hoxha, *Ditar 1955-1957*, f. 125.

mbajtur në prill 1956⁶. Një tjetër arsye mospajtimi ndërmjet udhëheqjes shqiptare dhe asaj sovjetike kishte të bënte me faktin se afrimi sovjeto-jugosllav, mund të reflektohej edhe në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Ai do ta vendoste udhëheqjen e lartë të PPSH përballë kritikave dhe fajësimeve brenda vendit, por edhe jashtë tij.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës e ndiqnin me kujdes situatën e krijuar në marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike dhe frymën përgjithësisht refuzuese të udhëheqjes së lartë shqiptare ndaj ndryshimeve të projektuara në Kongresin XX-të të Partisë Komuniste të BS. Shqipëria, në ndryshim nga vendet e tjera ish-socialiste dhe Jugosllavia e vitit 1948 mbeti në pozita staliniste, gjë që kushtëzoi në një masë të madhe edhe rolin që politika e Demokracive Perëndimore dhe ajo amerikane do t'i "ngarkonin" asaj në këto vite. Në vitet 1958-1960, SHBA nuk projekttoi ndonjë politikë të veçantë ndaj Shqipërisë. Sidoqoftë, bazë mbështetëse e politikës së saj u bë raporti i Këshillit Kombëtar të Sigurisë, i 22 majit 1958, i aprovuar nga Presidenti dy ditë më vonë. Qeveria amerikane bëri disa sondazhe për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike të ndërprera pas pushtimit italian të Shqipërisë në vitin 1939. Politika e saj ndaj Shqipërisë ishte pjesë e politikës së përgjithshme që ajo ndiqte ndaj Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera socialiste të Evropës, të kontrolluar prej tij. Shqipëria sipas raportit të datës 24 maj 1958 të Këshillit Kombëtar të Sigurisë, gjykohej si një vend "unik ndërmjet kombeve të kontrolluara (nga BRSS - H.K), për shkak të prapambetjes së saj politike, ekonomike dhe kulturore"⁷. Përkundër prirjes pas staliniste drejt liberalizimit si kudo tjetër në Bllokun Sovjetik, regjimi shqiptar kishte nxjerrë në pah pak shenja devijimi nga modeli stalinist. Shqipëria, theksohej më tej, paraqiste probleme të veçanta për politikën e Shteteve të Bashkuara, sepse tradicionalisht ajo kishte qenë subjekt i pretendimeve dhe ambicieve të rivalëve, të Greqisë, Italisë dhe Jugosllavisë dhe ajo kurrë nuk kishte qenë një komb me rëndësi parësore për Shtetet e Bashkuara"⁸.

⁶ Shih: Ana Lalaj, "Konferenca e Partisë së Tiranës, një pranverë e dështuar e së majtës në Shqipëri (14-19 prill 1956)", *Studime Historike*, nr. 1-2, 2009, f. 109-132.

⁷ Foreign Relations of United States (FRUS), 1958-1960. Eastern Europe Region, Soviet Union, Cyprus, Volume X, Part I, National Security Council Report, NSC 5811/1, Dokumenti 6, Washington, May 24, 1958, pp.22-23.

⁸ Po aty.

Lëvizjet diplomatike të SHBA për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Bullgarinë, por edhe me Shqipërinë synonin të nxisnin kontaktet e Perëndimit me Shqipërinë dhe do t'i inkurajonte ata të ecnin në të njëjtën rrugë si qeveria amerikane. Sondazhet e amerikanëve mund të sillnin rezultate pozitive, duke pasur në konsideratë rrethanat ndërkombëtare të ndodhura pas vdekjes së Stalinit dhe një lloj zbutje të klimës ndërkombëtare. Shqipëria pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike bullgaro-amerikane do të mbetej i vetmi vend ballkanik me të cilin SHBA nuk kishin marrëdhënie diplomatike. Sidoqoftë, ato risollën idenë e rivendosjen së marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, por duke kërkuar të respektoheshin disa kushte të qarta, që përfshinin garantimin dhe trajtimin korrekt të personelit diplomatik të SHBA në Shqipëri, si dhe pranimin e një zgjidhjeje të favorshme në lidhje me vlefshmërinë e traktateve të paraluftës ndërmjet dy vendeve⁹. Sondazhet amerikane u shtuan sidomos pas vizitës së Hrushovit në Shqipëri, në vitin 1959 dhe përhapjes së versionit se në Shqipëri mund të vendoseshin raketa sovjetike. Por, vetëm pas një viti, dhe pikërisht më 15 korrik 1959, në raportin e Bordit të Koordinimit Operacional (BKO) do të thuhet: “Autoritetet shqiptare nuk kanë treguar ndonjë interes direkt dhe të qartë, për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shtetet e Bashkuara. Nuk është arritur ndonjë përparim për arritjen e objektivave tona në lidhje me Shqipërinë”.¹⁰ Në të njëjtin konkluzion do të arrinte BKO edhe më 27 korrik 1960. SHBA nuk e mori vetë e para iniciativën për të paraqitur zyrtarisht propozimin, duke shpresuar se do të ishte Shqipëria pala më e interesuar për të ndërmarrë këtë hap. Në këtë kohë Shqipëria ishte i vetmi shtet evropian (përveç Gjermanisë Lindore) me të cilën SHBA nuk kishte marrëdhënie diplomatike.

Lëvizjet e qeverisë amerikane për të arritur në rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë nuk kaluan pa u vënë re nga qeveria shqiptare. Informacionet e para iu përcollën qeverisë shqiptare që në shtator 1957, përmes diplomatëve polakë në Washington, nëpërmjet artikujve të botuar nga gazetari amerikan Salisbery dhe shkrimeve të tjera në gazetatat “New York Times”, “New York Herald Tribune” etj. Por ndikimin më të madh duket se e patën bisedimet bullgaro-amerikane, të

⁹ FRUS, 1958-1960. Eastern Europe; Finland; Greece; Turkey, Volume X, Part 2, Implications of Khrushchev's visit to Albania, June 15, 1959, p. 95.

¹⁰ Po aty, Part 1: 05 - Eastern Europe, Report on Soviet - Dominated Nations in Eastern Europe (NSC 5811'1), Washington, July 15, 1959.

cilat u finalizuan në mars 1959, me rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy vendeve¹¹. Pala shqiptare e konsideronte po kështu pozitive lejimin nga qeveria amerikane të shtetasve amerikanë me origjinë shqiptare për të vizituar Shqipërinë. Më 6 prill 1959 qeveria shqiptare u informua nga Reiz Malile, përfaqësues i përhershëm i Misionit të Shqipërisë pranë Kombeve të Bashkuara në New York për sondazhet e qeverisë amerikane¹². Reiz Malile do të informonte: “neve deri tani, nuk kemi parë ndonjë hap konkret, ose sondazhe zyrtare nga ana e amerikanëve. Ndoshta, vazhdonte ai më tej, ata presin që iniciativën në këtë rast për të ndërhyrë zyrtarisht në rrugë diplomatike ta marrim neve”¹³. Për të kuptuar më mirë qëndrimin e amerikanëve për këtë çështje, Malile u propozoi eprorëve të vet në Tiranë, që të fillonin sondazhet e tyre përmes Misionit shqiptar në New York ose ambasadës çeke në Washington. Gati një muaj më pas, në përgjigje të kërkesës së ardhur nga Malile, ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Behar Shtylla do të njoftonte Misionin shqiptar në New York dhe ambasadën shqiptare në Pragë, se ai kishte biseduar me ministrin e jashtëm të Çekosllovakisë dhe kishin rënë dakord që sondazhet me amerikanët do të kryheshin nga ambasadori çek në Washington, por, si nënvizonte ai “me takt dhe pa treguar se jemi të interesuar”¹⁴. Dy ditë më pas Reiz Malile u takua me ambasadorin çek në Washington duke e vënë në dijeni për propozimin e mësipërm dhe duke i bërë atij të njohur edhe historinë e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve¹⁵.

Kulmi i interesimit të palës shqiptare do të arrihej më 1 gusht 1959, me vendimin e marrë nga Kolegjiumi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë¹⁶. Në mbledhjen e drejtuar nga ministri i Jashtëm Behar Shtylla u analizua raporti i paraqitur mbi marrëdhëniet shqiptaro-amerikane dhe u arritën disa përfundime. Me rëndësi paraqitej sidomos

¹¹ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme i Republikës së Shqipërisë (më tej: AMPJ), viti 1959, dos. 342, fl. 18.

¹² *Po aty*, viti 1959, dos. 339, Informacion i Reiz Maliles (Përfaqësuesi i Përhershëm i Shqipërisë në Kombet e Bashkuara) drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, nr. 56, 6 prill 1959.

¹³ *Po aty*, f. 12.

¹⁴ *Po aty*, Telegram i Behar Shtyllës për ambasadën e Shqipërisë në Pragë dhe Misionin e Shqipërisë në Kombet e Bashkuara, nr. 1123, më 7 maj 1959.

¹⁵ *Po aty*, Telegram i Reiz Maliles për MPJ, nr. 227, më 9 maj 1959.

¹⁶ AMPJ, viti 1959, dos. 342, Vendim i Kolegjiumit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, më 1 gusht 1959, fl. 26-27.

fakti që me vazhdimin e sondazheve përveç ambasadës çeke, ngarkohej edhe Misioni Shqiptar në Kombet e Bashkuara, të cilit iu bë e ditur se nëse qeveria amerikane do të ishte e gatshme, ai do të propozonte të fillonin bisedimet zyrtare ndërmjet dy vendeve. Sidoqoftë, pala shqiptare do të përsëriste edhe njëherë kushtet e saj në lidhje me rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike: pranimin e pothuajse të gjitha marrëveshjeve ndërkombëtare dhe diskutimin e marrëveshjeve dy palëshe pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike. Qeveria shqiptare shprehej e gatshme të zhvillonte marrëdhënie tregtare dhe të priste turistët amerikanë me origjinë shqiptare në Shqipëri. Në kategorinë e fundit ajo përfshinte edhe shtetasit amerikanë me origjinë nga minoriteti grek i Shqipërisë. Një detyrë e veçantë iu ngarkua shtypit shqiptar, i cili duhej t'u përgjigjej indirekt shkrimeve të shtypit amerikan për qëndrimin e Shqipërisë ndaj problemit të rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike¹⁷. Ashtu si në vitet 1945-1946, edhe në vitin 1959, qeveria shqiptare do të ngulte këmbë për rishikimin e traktateve dhe marrëveshjeve dypalëshe, të nënshkuara para vitit 1939 dhe diskutimin e tyre pas rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike¹⁸. Por vetëm dy javë më vonë, Zëvendësministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Vasil Nathanaili do t'u bënte të ditur të gjitha përfaqësive shqiptare: “ne nuk marrim asnjë iniciativë, pozita jonë është e fortë. Në rast se afrohet ndonjë përfaqësues diplomatik, mbani të njëjtin qëndrim korrespondues por asgjë më tepër. Në rast se ju bën propozime i thoni se do t'ia transmetojmë qendrës. I njëjti qëndrim të mbahet edhe me përfaqësuesit e Anglisë dhe të Greqisë. Iniciativa nga ana jonë të mos ketë”¹⁹. Urdhëri i fundit e zbehu procesin e nisur dhe të dyja palët iu përmbajtën vendimeve të marra në instancat më të larta. Duket se udhëheqja shqiptare, pas sigurimeve për mbështetje që merrte prej Kinës, e konsideroi të panevojshëm vazhdimin e mëtejshëm të sondazheve, pavarësisht se pas urdhrit të zëvendësministrit dokumentohen edhe disa takime e biseda sporadike ndërmjet diplomatëve për këtë çështje.

Gatishmërinë e qeverisë Shqiptare për të vendosur marrëdhënie diplomatike me Britaninë e Madhe e shprehu edhe kryeministri i vendit, Mehmet Shehu, në Sesionin e 15 të Kombeve të Bashkuara në New York. Mehmet Shehu në intervistën e dhënë për *Dailey Telegraph*, më 11

¹⁷ *Po aty*.

¹⁸ *Po aty*, f. 26.

¹⁹ *AMPJ*, viti 1959, dos. 339, Telegram i Vasil Nathanailit drejtuar përfaqësive shqiptare, nr. 203, 19 gusht 1959, fl 22.

tetor 1960, do të shprehej se “qeveria shqiptare e ka shpallur disa herë, se dëshiron të vendosë marrëdhënie me Britaninë e Madhe, në bazë të parimeve të njohura dhe se ajo nuk sheh ndonjë gjë të pazgjidhshme ndërmjet dy vendeve”²⁰. Por duhet përmendur se edhe Britania e Madhe nuk tregoi ndonjë interes të veçantë për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë. Ajo iu përmbajt politikës së dhënies së dëmshpërblimeve të caktuara nga Gjykata e Hagës për incidentin e Kanalit të Korfuzit, përpara se të procedohej më tej për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Britania e Madhe, në dhjetor 1959, ngarkoi ambasadorin e saj në Uashington që të kontaktonte për këtë problem me Departamentin e Shtetit. Nga Uashingtoni, ai do t’i shkruante qendrës së vet në Londër, se këtu nuk kishte ndonjë aksion konkret për këtë problem, dhe thjesht ai do t’i konsideronte “thashetheme dhe balona fluturuese” fjalët e përhapura rreth kësaj çështjeje²¹. Në shkurt 1960, diplomati britanik në Uashington J. B. Denson do të shfaqte opinionin “jo zyrtar” se, britanikët nuk nxitonin për të vendosur marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë dhe se nuk do të ishte e pëlqyeshme që ata, të merrnin të parët iniciativën, pa zgjidhur më parë pretendimet britanike për incidentin e Kanalit të Korfuzit²². Si një vend anëtar i NATO-s, dhe pa interesa të veçanta në Shqipëri, Britania e Madhe do të ruante po të njëjtën linjë si edhe SHBA në marrëdhëniet me Shqipërinë.

Perëndimi: Shqipëria - faktor përcarës ndërmjet Kinës dhe Bashkimit Sovjetik

E çara sovjeta-shqiptare ndonëse derivat i konfliktit sovjeto-kinez, i shtoi më tej mosmarrëveshjet dhe mungesën e unitetit brenda Bllokut Komunist. Ajo sigurisht ishte e favorshme për aleatët perëndimorë, të cilët duhet thënë, nuk kishin të njëjtën shkallë ndjeshmërie ndaj saj. Brenda NATO-s interesat e Greqisë dhe të Italisë shkonin përtej interesave të vendeve të tjera anëtare. Në rrethanat e krijuara aleatët perëndimorë duhej të përpunonin politika të përbashkëta ndaj Shqipërisë si dhe hapat e mëtejshme për marrëdhëniet me të. Ishte e qartë se SHBA, si vendi lider i grupimit do t’i duhej të përvijonte politikën e ardhshme

²⁰ “Daily Telegraph”, October 11, 1960, cituar nga: National British Archives (NBA), F.O./371, Year 1960, File 152816.

²¹ NBA, File 144439, British Embassy, Washington, D.C. to Foreign Office, December 4, 1959.

²² NBA, File 152816, J.B. Denson to Foreign Office, February 11, 1960.

ndaj Shqipërisë. Për vendet e aleancës perëndimore ishte kristalizuar mendimi për karakterin stalinist të udhëheqjes shqiptare, por sidoqoftë çarja me Bashkimin Sovjetik gjykohej si situatë e favorshme për Perëndimin e cila duhej të shfrytëzohej. Në fillimet e krizës nuk ishte kristalizuar qëndrimi që duhej mbajtur ndaj Shqipërisë, por sidoqoftë nuk mendohej se ndaj saj, mund të ndiqej e njëjta politikë që ishte ndjekur gjatë konfliktit sovjeto-jugosllav të vitit 1948. Politika e Perëndimit u modelua në proces, derisa mori formën përfundimtare pas ndërprerjes së marrëdhënieve diplomatike të Shqipërisë me BRSS.

Duhet të përmendim se, as udhëheqja komuniste e Shqipërisë nuk e mendoj seriozisht alternativën e orientimit të vendit drejt Perëndimit. Ajo nuk u gjend asnjëherë në udhëkryq politik për rrugën dhe aleatin që duhej të zgjidhte. Udhëheqja shqiptare u gjend në vështirësi sidomos në fillim të konfliktit me BS, por me kalimin e kohës ajo vendosi lidhjet e duhura me Kinën dhe si rrjedhojë interesi për vendet perëndimore erdhi duke u zbehur. Ajo u dërgoi disa sinjale vendeve perëndimore, të cilat kishin të bënin kryesisht me rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me SHBA, Britaninë e Madhe, Greqinë etj., dhe hapjen e mundshme të kanaleve ekonomike për të marrë ndihma prej tyre. Por interesi i saj ndaj Perëndimit erdhi duke u zbehur në çastin që ajo vendosi urat lidhëse me Kinën komuniste, e cila i siguronte udhëheqjes shqiptare garancitë e duhura. Kina përmbushte kushtet për të qenë vendi aleat i udhëheqjes shqiptare. Në fund të viteve '60 Kina ndiqte një politikë komuniste konservatore, kundër sovjetike, kundër jugosllave dhe njëkohësisht kundër perëndimore. Por ajo ishte në gjendje gjithashtu të mbulonte nevojat ekonomike të Shqipërisë, ndonëse ishte në vështirësi të mëdha brenda vendit. Në ankorimin e Shqipërisë drejt një shteti të largët si Kina, duhet marrë në konsideratë edhe një arsye tjetër: fakti që Kina ishte një vend i largët që nuk rrezikonte sundimin e udhëheqjes shqiptare brenda vendit, por nuk rrezikonte as pavarësinë e saj sikurse kishte ndodhur me aleancat e shkuara të Shqipërisë.

Për aleancën e shteteve perëndimore do të ishte më e pranueshme dhe më e favorshme ekzistenca e një shteti shqiptar të pavarur, si nga BS ashtu edhe nga Kina. Por udhëheqja shqiptare plotësonte vetëm njërin kusht, atë të armiqësisë me BS, ndërkohë që po orientohej totalisht nga Kina e Mao Ce Dunit, një vend më i pa reformuar dhe më armiqësor me Perëndimin. Për aleancën e shteteve perëndimore idetë dhe politika e Hrushovit, ndonëse socialiste në thelbin e tyre, ishin më të pranueshme se

sa ato të kinezëve dhe shqiptarëve, që vazhdonin të ecnin në rrugën e Stalinit. Në një takim të Shtabit të Planifikimit të Politikave, Xhorxh F. Kennan²³ do të deklaronte se amerikanët po hasnin probleme më të mëdha me kinezët se sa me rusët. Për Hrushovin dhe politikën e tij ai do të shprehej: “Hrushovi, pavarësisht nga mburrjet është burrë i ndjeshëm. Ne duhet të jemi të duruar dhe me humor kur merremi me të. Ne nuk duhet të shqetësohemi nga deklarata e tij, se Bashkimi Sovjetik ka si qëllim të na varrosë ne të gjallë - kjo është metaforë dhe lideri sovjetik e di mirë deri ku shtrihen interesat e tij të vërteta”²⁴. “Ne, shtonte Kennan, kemi shumë më tepër probleme të vështira me kinezët se sa me sovjetikët. Të fundit kanë më tepër të përbashkëta me civilizimin Perëndimor”²⁵.

Politikbërësit amerikanë u treguan shumë të matur në përcaktimin e qëndrimit të tyre ndaj krizës shqiptaro-sovjetike. Në fazën e parë u grumbulluan informacione dhe rekomandime të rëndësishme nga terreni dhe pas përpunimit të tyre u arrit të formësoheshin politika për veprim në instancat më të larta politike të SHBA. Amerikanët shfrytëzuan sidomos misionet e tyre diplomatike në vendet fqinje të Shqipërisë, shërbimet diplomatike të Francës, Italisë, Turqisë dhe Jugosllavisë në Tiranë, agjencitë e veta të shërbimit informativ, shtypin, emigracionin politik shqiptar etj.

Departamenti i Shtetit e konsideroi në këtë kohë Jugosllavinë si shtetin më të interesuar dhe njëkohësisht më të mundshmin për të ndërmarrë ndonjë aksion kundër Shqipërisë, i cili do të çonte në rrëzimin e regjimit të Hoxhës. Për këtë qëllim, në vitin 1961 u rithirr në shërbimin diplomatik dhe u emërua ambasador në Beograd, Xhorxh Kennan. Kennan ishte i njohur për modelimin e politikës amerikane gjatë Luftës së Ftohtë dhe njëkohësisht mbahej si ekspert për zhvillimet e brendshme dhe të jashtme të BS dhe vendeve të tjera socialiste. Kennan brenda një periudhe të shkurtër u dha përgjigje të mjaftueshme shqetësimeve të

²³ George F. Kennan - diplomat i shquar amerikan i periudhës së Luftës së Ftohtë. Në vitin 1947 ai u bë ideator dhe zbatues i politikës së “Frenimit” ose “Përbajtjes”. Kennan e paraqiti filozofinë e tij të “Frenimit” përmes një artikulli të botuar në revistën prestigjioze “Foreign Affairs” në vitin 1947. Kennan për disa vjet ishte në krye të Stafit të Hartimit të Politikave në Departamentin e Shtetit, ndërsa në vitin 1952 ai u emërua ambasador i SHBA në BS. Në pikun e krizës shqiptaro-sovjetike, Kennan u emërua ambasador i SHBA në Jugosllavi. Kennan ka qenë gjithashtu anëtar i Institutit të Studimeve të Avancuara në Universitetin e Prinstonit.

²⁴ National Archives and Record Administration (NARA), RG, 59, Year 1961, Policy Planning Staff Meeting, February 8, 1961, p.2.

²⁵ Po aty, p.3.

Perëndimit për dy problemet më të rëndësishme: mundësisë së ndërmarrjes së ndonjë sulmi kundër Shqipërisë, nga ana e Jugosllavisë apo BS dhe së dyti, argumentoi dhe hodhi bazamentin e politikës që Perëndimi do të ndiqte në të ardhmen ndaj Shqipërisë.

Në nëntor 1961, në kulmin e krizës shqiptaro-sovjetike, Kennan do t'i përcillte Sekretarit Amerikan të Shtetit disa raporte të rëndësishme nga Beogradi. Ai do të raportonte se nuk ekzistonin dëshmi të mjaftueshme që të provonin ekzistencën e ndonjë sulmi të mundshëm nga ana e Jugosllavisë apo edhe BS kundër Shqipërisë, pavarësisht se Jugosllavia ishte shteti më i interesuar për të ndryshuar regjimin komunist të Shqipërisë. Kennan bënte të qartë se, jugosllavët i ndiqnin me vigjilencë të madhe zhvillimet në Shqipëri dhe e dëshironin rrëzimin e Hoxhës dhe zëvendësimin e tij me një regjim jugosllav. Sipas ambasadorit amerikan, mjeti më i mirë për të realizuar ndryshimet në Shqipëri do të ishin intrigat dhe manipulimet brenda radhëve të Partisë së Punës së Shqipërisë, duke mos përdorur domosdoshmërisht ndërhyrjen ushtarake, e cila do të rrezikonte shumë sigurinë e Jugosllavisë. Jugosllavët në këtë kohë sipas Kennan, nuk e “zotëronin teknologjinë e brendshme për të realizuar puçin”²⁶. Enver Hoxha me politikën e egër të spastrimeve, sipas burimeve jugosllave, i kishte eliminuar pothuajse të gjithë elementët komunistë shqiptarë, që mund të mbështetnin sovjetikët apo jugosllavët gjatë konfrontimit²⁷ dhe kishin mbyllur çdo rrugë që mund të çonte në rrëzimin e tij nga brenda. Sidoqoftë ambasadori Kennan pretendonte se, “jugosllavët po ndërmerrnin disa përpjekje armiqësore” në Shqipëri. Por udhëheqja jugosllave ishte gjithashtu shumë e ndjeshme kundër ndërmarrjes së çfarëdo aksioni të fortë kundër Shqipërisë, sidomos nga ana e NATO-s. Ajo kundërshtonte edhe ndërhyrjen e Bashkimit Sovjetik. Sovjetikët, sipas gjykimit të Kennan, do të humbisnin shumë nëse ndërmerrnin një ndërhyrje të drejtpërdrejtë ushtarake në Shqipëri²⁸. Kennan arriti në përfundimin se jugosllavët nuk ishin në gjendje të ndikonin mbi rrjedhën e ngjarjeve në Shqipëri, pavarësisht se ajo nuk u pëlqente. Ndërsa për qëllimet e sovjetikëve do shprehte opinionin, se tani për tani ata nuk janë në gjendje të ndryshojnë gjendjen ekzistuese.

²⁶ Record of Department of State relating Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Roll 1, Kennan to Secretary of State, November 19, 1961.

²⁷ Po aty, Kennan to Secretary of State, November 25, 1961.

²⁸ Po aty.

Mundësia e rrëzimit të udhëheqjes komuniste të Shqipërisë nga sovjetikët nëpërmjet një grushti shteti, shihej me dyshim edhe nga francezët, sepse Shqipëria mund të dilte jashtë kontrollit dhe mund të shkonte në shtigjet e Jugosllavisë, ose mund të ndodhte diçka më e keqe për rusët. Udhëheqja shqiptare po bëhej një “mallkim për Moskën”²⁹. Ndërsa Jugosllavia, vazhdohej më tej, po tregonte shumë pjekuri në qëndrimin ndaj Shqipërisë. Nëse ata do të ndërmerrnin të vetëm ndonjë aksion kundër udhëheqjes shqiptare mund të dështonin, pasi do të prisheshin me rusët të cilët ishin nga pikëpamja ideologjike më afër shqiptarëve se sa jugosllavët³⁰.

Më 21 nëntor 1961 Kennan do t'i përcillte Sekretarit Amerikan të Shtetit një raport të shkurtër, por të rëndësishëm në lidhje me politikën që Perëndimi duhej të ndiqte ndaj Shqipërisë³¹. Raporti, për shkak të vlerave të tij, iu dërgua edhe ambasadave amerikane në Athinë, Romë, Paris, Londër dhe Moskë. Ambasadori Kennan do të hidhte në tryezën e politikës amerikane disa opsione, të cilat nuk përkonin plotësisht me ato të Departamentit të Shtetit. Varianti i parë, parashikonte shkëputjen e Shqipërisë me forcë nga Blloku Komunist dhe bashkimin e saj të nënkuptuar me Perëndimin. Ky version mendohej i pamundur për t'u realizuar në atë çast kritik, sepse sipas tij, ai do të shkaktonte ndërhyrjen e Jugosllavisë dhe ndofta edhe të Bashkimit Sovjetik, gjë që do ta ndërlikonte shumë situatën. Por, zbatimi i tij do të sillte edhe vështirësi të tjera për aleatët perëndimorë të NATO-s, sepse ai mund të shoqërohej me shtimin e rivaliteteve brenda radhëve të saj, duke nënkuptuar kështu Italinë dhe Greqinë si vende anëtare të Aleancës së Atlantikut të Veriut. Varianti i dytë parashikonte ekzistencën e Shqipërisë si shtet komunist, të orientuar drejt Kinës. Ky variant, i parë nga këndvështrimi perëndimor, mendohej si më i leverdisshëm, sepse Shqipëria do të vazhdonte të mbetej “mollë sherri” ose “ferrë” brenda botës komuniste. Por situata jo e qëndrueshme e Shqipërisë do të varej shumë në të ardhmen nga qëndrimi i Kinës dhe nga sigurimi i ndihmave të saj për regjimin shqiptar. Në se Kina nuk do t'u rikthehej lidhjeve të saj me BS dhe do ta ndihmonte plotësisht regjimin shqiptar atëherë ky shihej si versioni më komod për Perëndimin. Varianti i fundit dhe njëkohësisht më i pëlqyeri për

²⁹ NBA, File 160341, British Embassy in Paris to Foreign Office, October 30, 1961.

³⁰ Po aty.

³¹ Po aty, Kennan to Secretary of State, No. 794, November 21, 1961.

Perëndimin, do të ishte në fakt ekzistenca e një regjimi shqiptar sipas modelit të Titos. Duke e detajuar e qartësuar më tej idenë e tij, Kennan do të shpjegonte se, regjimi i pëlqyer do të ishte njëkohësisht një lloj revizionizmi që drejtohej në “shtigje socialiste”, dhe po kështu më liberal se aktuali, por që do të ruante njëkohësisht pavarësinë nga Moska dhe Pekini. Kennan shihte si elementin më të rëndësishëm të këtij versioni, orientimin e tij nga Lindja dhe Perëndimi, njëkohësisht. Në analizën e tij ambasadori amerikan do të nënvizonte edhe një detaj tjetër të rëndësishëm dhe të favorshëm për Perëndimin, faktin që zbatimi i tij nuk do të sillte ndërlikime dhe shqetësime për paqen ndërkombëtare dhe situatën në botë. Në paraqitjen e kësaj ideje Kennan do të kishte në konsideratë edhe eksperiencën e fituar nga zhvillimet në Hungari në vitin 1956, ku ishte shkaktuar një “banjë gjaku”, por nuk ishin arritur objektivat e Perëndimit dhe të vetë popullit hungarez. Kennan, do ta vlerësonte variantin e fundit, si maksimumin e asaj se “çfarë ne duam të shohim dhe të pretendojmë në rrugën e miqësisë dhe përgjegjësisë, për këtë vend të palumtur, të pazakontë dhe të parë me sy të keq”³². Por ai do të shtonte me keqardhje në fund të raportit të tij, se as ky variant nuk mund të zbatohet në Shqipëri, në “këtë vend të fiksuar stalinist dhe dogmatik” të drejtuar nga Hoxha. Përfundimisht Kennan do të arrinte në konkluzionin se, ky shtet nuk duhet të ndihmohej nga Perëndimi. Në vështrimin e ambasadorit amerikan, situata shqiptare dukej fluide, e paparashikueshme dhe në zhvillim. Në ato rrethana, ai do t’i rekomandonte DSH që të mos ndërmerrej prej tij ndonjë vendim afat gjatë, i cili do të përjashtonte mundësitë për të qenë elastik, në ndërmarrjen e politikave të ardhshme. “Për momentin, nënvizonte Kennan, mua më duket që këshilla më e mirë është që ta lëmë në punën e vet (Shqipërinë, H.K.) dhe të abstenojmë nga ndonjë aksion i avancuar. Duke e gjykuar Shqipërinë si burim telashesh dhe përçarjesh brenda Bllokut Komunist, Kennan do ta vlerësonte situatën shqiptare në të mirë të Perëndimit, sepse e linte këtë të fundit jashtë çdo përgjegjësie të mundshme. Ai do ta mbështeste këtë variant, duke shtuar se “si ka vajtur puna, sigurisht ne nuk do të priremi ta përmirësojmë duke ndërhyrë në këto rrethana”³³.

³² Po aty.

³³ Po aty.

Filozofia e përdorimit të Shqipërisë si faktor përçarës brenda Bllokut Komunist duket se kishte zënë vend edhe në strategjitë e vendeve të tjerë të Aleancës. Në Ministrinë e Jashtme të Francës ndiqeshin me vëmendje ngjarjet e Shqipërisë dhe prononcimet e qeverisë shqiptare për të forcuar lidhjet ekonomike me Francën. Por, francezët në rrethanat e krijuara nuk shihnin “ndonjë arsye për të ndihmuar shqiptarët”. Ata i joshte më shumë ideja “e ushqimit të zjarrit të mosmarrëveshjes në bllokun sovjetik”, i cili do të ishte rezultat i kësaj gjendjeje³⁴.

Të njëjtin qëndrim francezët do të mbanin edhe në një takim të NATO-s në vitin 1961, ku përfaqësuesi i tyre u shpreh për t’i dhënë një ndihmë të vogël Shqipërisë sa për mbijetesë, me qëllim që shqiptarët “të ishin ferrë në këmbët e BRSS”³⁵. Për përfaqësuesin francez ideja e konvertimit të shqiptarëve me Perëndimin ishte e perealizueshme, për shkak të qëndrimit të njohur stalinist të udhëheqjes së PPSH. Edhe shkëputja e Shqipërisë nga Kina, gjykohej gjithashtu si e pamundur. Pak a shumë në këtë linjë gjykimi ishin edhe përfaqësuesit e vendeve të tjerë. Vita Fintzi, ish ministër i Italisë në Shqipëri, do t’i cilësonte komunistët shqiptarë si më të pakorrigjueshmit dhe se ideja e të punuarit me ta do të ishte e perealizueshme dhe nuk do të sillte asgjë. Por në ndryshim nga përfaqësuesi francez, ai mendonte se, nuk duheshin kufizuar ndihmat e Perëndimit për Shqipërinë. Të gjithë të pranishmit në takimin e NATO-s e pranuan si politikën më të mirë rolin e Shqipërisë si faktor përçarës brenda botës komuniste dhe në veçanti ndërmjet Kinës dhe Bashkimit Sovjetik.

Në mbledhjen e NATO-s u trajtua edhe versioni i ndërmarrjes së ndonjë sulmi të papritur nga ana e Jugosllavisë mbi Shqipërinë, të mbështetur edhe nga BS. Një situatë e tillë nuk do të kishte qenë e pëlqyer për Perëndimin, por as fatale për interesat e tij. Çuditërisht me këtë opsion u bashkua edhe ministri grek në NATO, i cili në mënyrë të papritur do të deklaronte: “qeveria e tij nuk kishte ndonjë pretendim territorial mbi Shqipërinë, por ajo shqetësohej për minoritetin grek atje”³⁶. Qëndrimi konformist dhe i paparashikuar i ministrit grek, do të qartësohej më tej, kur ai do të shtonte se, qeveria e tij mund të merrej vesh me jugosllavët, të cilët gëzonin reputacion të mirë në trajtimin e minoriteteve. Një arsyetim i tillë linte vend për dyshime, pasi dihej se në

³⁴ NBA, File 160341, British Embassy in Paris to Foreign Office, July 25, 1961.

³⁵ Record of the Department of State relating Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Roll 1, November 22, 1961.

³⁶ Po aty.

të shkuarën këto dy shtete ishin përpjekur të arrinin marrëveshje për ndarjen e territoreve shqiptare. Greqia dhe Jugosllavia, duke qenë të dyja vende anëtare të Paktit Ballkanik, kishin më shumë mundësi për t'u marrë vesh me njëra-tjetrën në kurriz të Shqipërisë. Dyshimet për arritjen e ndonjë marrëveshjeje të tillë ndërmjet këtyre dy shteteve ishin bërë të njohura sidomos nga politikanët italianë, por edhe nga vetë udhëheqja shqiptare.

Për situatën e tensionuar ndërmjet Shqipërisë dhe BS dhe mundësinë e afrimit politik të Shqipërisë me Perëndimin, do të shfaqte interes edhe Ministria e Jashtme e Gjermanisë Perëndimore. Në lidhje me këtë subjekt, ajo do t'i kërkonte informacion ambasadës së Britanisë së Madhe në Bon. Në përgjigje të saj, ambasada britanike do t'i bënte të njohur palës gjermano-perëndimore se, ajo nuk kishte dijeni për fjalët që qarkullonin se Perëndimi po përpiqej të përmirësonte dhe zgjeronte marrëdhëniet me Shqipërinë³⁷. Ambasada e Britanisë së Madhe në Bon nga ana tjetër do t'i përcillte qendrës së vet në Londër, konkluzionet e një raporti gjermano-perëndimor mbi krizën shqiptaro-sovjetike. Raporti i dalë nga zyrat e diplomacisë gjermane do të nënvizonte se marrëdhëniet e Shqipërisë me fqinjët e saj, jugosllavë dhe grekë, ishin si përherë të tensionuara; se marrëdhëniet me BS kishin qenë të tensionuara që nga viti 1958, gjithashtu dhe me disa prej vendeve satelite të tij, që nga viti 1960; se Shqipëria ka qenë e mbështetur nga Kina; se dallimet e Shqipërisë me BS ishin shprehur përmes termave ideologjike, por sidoqoftë ato kishin një bazë konkrete nacionaliste, para së gjithash, frikën se Jugosllavia mund të ri pajtohej me BS dhe të përmbyste udhëheqjen e tanishme të Shqipërisë. Gjermanët mendonin se afrimi i Tiranës me Pekinin shprehej gjithashtu me terma ideologjikë. Sipas tyre, mosmarrëveshjet ndërmjet dy vendeve kishin baza politike dhe nacionaliste. Diplomacia gjermano-perëndimore e gjykonte të pamundur përdorimin e forcës ushtarake mbi Shqipërinë nga ana e Ruisë, dhe jo efektiv ushtrimin e presioneve ekonomike, pasi Shqipëria mbështetej ekonomikisht nga Kina. Ata mendonin se, rusët po komplotonin kundër regjimit të Hoxhës, duke shfrytëzuar për këtë qëllim grupet e brendshme armiqësore me të. Loja e udhëheqjes shqiptare konsiderohej e rrezikshme për ata vetë dhe se ajo do të ishte e suksesshme për aq kohë sa do të zgjaste konflikti sovjeto-kinez.

³⁷ NBA, File 160341, British Embassy, Bonn to Central Department of Foreign Office, June 22, 1961.

Gjermanët konstatonin me të drejtë se shqiptarët po prisheshin me Bllokun Komunist.

Marrëdhëniet e ndera shqiptaro-sovjetike dhe shqiptaro-jugosllave do të tërhiqnin vëmendjen e diplomacisë turke. Ministria e Jashtme e Turqisë i shpjegonte mosmarrëveshjet me BS dhe Jugosllavinë kryesisht për arsye të diferencave ideologjike ndërmjet partive të tyre dhe pjesërisht me mendimin se, PPSH ishte një “eko e politikës kineze dhe satelite e Kinës”³⁸. Sipas diplomacisë turke shkaqet e marrëdhënieve të këqija të Shqipërisë me Jugosllavinë gjendeshin tek relacionet sovjeto-kineze dhe dogmatizmi i udhëheqjes shqiptare. Por në ndryshim nga opinionet e vendeve të tjera, diplomacia turke e shihte të ardhmen e Shqipërisë sërish të bashkuar me atë të BS. Edhe marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave do të përmirësoheshin, sepse udhëheqja shqiptare do të ndiqte BS në qëndrimin e saj ndaj Jugosllavisë. Sipas turqve, udhëheqja shqiptare po merrte disa masa për të siguruar pavarësinë nga Moska, por ajo nuk dëshironte të provokonte Moskën deri në atë shkallë, sa të rrezikohej dhënia e ndihmës së premtuar për Shqipërinë. BS mund të ndërmernte ndonjë komplot për të përmbysur udhëheqjen e tanishme të Shqipërisë, por turqit mendonin se rusët nuk do ta ndërmerren këtë hap. Shqiptarët gjithashtu në të ardhmen do të ndiqnin Rusinë në trendin e tyre ndaj jugosllavëve. Të veçanta ishin edhe interpretimet e diplomatëve turq në lidhje me arsyet e dënimit të grupit të Teme Sejkos. Teme Sejko dhe mbështetësit e tij, sipas tyre ushqenin pakënaqësi për udhëheqjen aktuale të vendit dhe me mbështetjen e Ruisë dhe vendeve satelite të saj, ata ishin përpjekur të përmbysnin Hoxhën. Admirali Sejko dhe miqtë e tij, në raportin e Ministrisë së Jashtme të Turqisë konsideroheshin si rrezik jetësor për pozitën e Hoxhës, i cili nuk mund ti toleronte ata. Kundër rrjedhës së gjykimeve të vendeve të tjera perëndimore, ishin gjithashtu arsyetimet se, spastrimet e fundit të elementëve pro rusë dhe kundër Hoxhës, nuk binin domosdoshmërisht ndesh me teorinë turke të përmirësimit të marrëdhënieve të Shqipërisë me Rusinë. Diplomacia turke e parashikonte të ardhmen e Hoxhës sërish në gjirin e vendeve të Bllokut Komunist. Sipas tyre, Shqipëria në të ardhmen do të ndiqte një politikë bashkëpunimi me BS. Ky trend do të ishte më i dukshëm sidomos në fushën e politikës së jashtme, por nënvizohej se, udhëheqja shqiptare do

³⁸ Po aty, British Embassy, Ankara to Central Department of Foreign Office, No. 10730/5, June 17, 1961.

të vazhdonte të ruante një lloj pavarësie nga Moska për çështjet e doktrinës. Turqit gjykonin se në të ardhmen edhe Moska do të gjente një “modus vivendi” në marrëdhëniet me udhëheqjen shqiptare, i cili do të çonte në përmirësimin e tyre³⁹. Koha tregoi që prognoza e diplomacisë turke ishte larg realitetit, ndonëse ata kishin në Tiranë përfaqësinë e tyre diplomatike.

Kongresi XXII i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik duket se daraviti çdo dyshim për ripajtimin shqiptaro-sovjetik. Më 21 tetor 1961, ambasada britanike në Moskë i përcolli qendrës së vet në Londër një përmbledhje të fjalimeve të mbajtura nga lider të ndryshëm të Bllokut Komunist kundër udhëheqjes shqiptare⁴⁰. Mikoiani, do të fajësonte për gjendjen e krijuar udhëheqjen shqiptare, duke sulmuar me emër Hoxhën dhe Shehun, të cilët do t'i akuzonte për rrëshqitje në shtegun e nacionalizmit. Miqësia me Partinë Komuniste dhe popullin sovjetik mund të fitohej, sipas tij, vetëm nëse shqiptarët ndaheshin nga stalinizmi dhe dogmatizmi. Më i rrepti nga udhëheqësit socialistë u tregua Kadari, i cili foli në kongres për “dorëzim pa kushte ose për largimin e udhëheqjes aktuale shqiptare”⁴¹.

Pas Kongresit XXII të PKBS, u duk qartë se çarja sovjeto-shqiptare ishte e pariparueshme. Ajo po ndikonte fuqishëm mbi marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë, në të dyja fushat, në atë politike dhe atë ekonomike. Politika e Moskës nuk mundi të gjente zgjidhjen e duhur për krizën me Shqipërinë. Konflikti jo vetëm që nuk u zvogëlua, por u shtua më tej dhe u bë më i tensionuar. Pas ndërprerjes së marrëdhënieve diplomatike në dhjetor 1961, Moska ndoqi politikën e sanksioneve ndaj Shqipërisë, si anulimi i kredive, tërheqja e asistencës teknike, zvogëlimi drastik i tregtisë dhe shkëmbimeve të tjera ekonomike etj. Ndihma e Kinës për Shqipërinë u rrit, por sidoqoftë ajo nuk mundi të arrinte për një kohë të shkurtër nivelin e ndihmave të mëparshme të dhëna nga BS dhe vendet e tjera socialiste. Si kundër përgjigje Shqipëria vazhdoi të kërkonte të avanconte shkëmbimet tregtare me vendet jo komuniste, por sidoqoftë ato mbetën të kufizuara dhe jo esenciale për nga rëndësia e tyre. BS, në dallim nga politika që kishte ndjekur ndaj Jugosllavisë, u lejoi vendeve satelite të tij që të mos e anulonin plotësisht ndihmën për Shqipërinë. Po kështu ai nuk kërkoi ta përjashtonte Shqipërinë *de jure* as

³⁹ Po aty.

⁴⁰ Po aty, Mr. Barker, from Moscow to Foreign Office, No. 1912, October 21, 1961.

⁴¹ Po aty.

nga Traktati i Varshavës dhe as nga KNER-i. Ky ndryshim duket se u kushtëzua nga vetë politika staliniste e udhëheqjes shqiptare, e cila nuk u afrua me Perëndimin, si dikur Jugosllavia, por edhe nga vetë politika e BS, i cili e shihte Traktatin e Varshavës në të ardhmen si një instrument shprese dhe mundësie për të ndryshuar me forcë dhe në favor të tij, marrëdhëniet me Shqipërinë.

Në rrethanat e krijuara Departamenti i Shtetit u përpoq të formësonte politika të qëndrueshme dhe efektive për Shqipërinë. Në funksion të kësaj politike amerikanët kërkuar të informoheshin hollësisht nga vendet mike të tyre, në lidhje me nivelin e mosmarrëveshjeve shqiptaro-sovjetike dhe shkallën e mbështetjes së Shqipërisë nga Kina. Interesat e tyre u fokusuan sidomos në njohjen, trajtimin e misioneve shqiptare dhe banorëve rezident në vendet socialiste; në sjelljen e qeverisë shqiptare ndaj minoriteteve etnike në vend; te numri i studentëve dhe turistëve shqiptarë jashtë vendit; te shkalla e shkëmbimit dhe niveli i delegacioneve të Shqipërisë me vendet komuniste; te pjesëmarrja e përfaqësuesve të Shqipërisë në mbledhjet e Këshillit Ekonomik të Ndihmës Reciproke (KNER) dhe në organizmat e tjera të përbashkëta të tyre; te niveli i marrëdhënieve tregtare të Shqipërisë me vendet socialiste dhe jo socialiste; te predispozitat e regjimit komunist për të forcuar lidhjet ekonomike me Perëndimin etj. Interesat e amerikanëve përfshinë gjithashtu njohjen më të mirë të situatës së brendshme në Shqipëri, duke u fokusuar veçanërisht tek shkalla dhe mbështetja që gëzonte regjimi i Hoxhës brenda vendit dhe tek gjendja reale e forcave opozitare në Shqipëri.

Më 9 janar 1962, ministri amerikan në Romë, Horsey dhe sekretari i dytë i kësaj ambasade Stephen Peters⁴², zhvilluan një takim me disa nga përfaqësuesit më të shquar të emigracionit politik antikomunist në Itali, pikërisht me Ismail Vërlacin, kryetar i Bllokut të Pavarur Kombëtar, me Ali Këlcyrën, kryetar i Organizatës së Frontit Kombëtar dhe profesor Ernest Koliqin, pedagog në Universitetin e Romës⁴³. Përfaqësuesit e

⁴² Stephen Peters ose Petro Stefani kishte punuar si mësues në shkollën Normale të Elbasanit. Më vonë ai emigroi në SHBA dhe punoi për disa vjet në Departamentin e Shtetit. Pas daljes në pension DSH e aktivizoi sërish si specialist të jashtëm për problemet shqiptare. Petro Stefani ka hartuar disa studime të rëndësishme për Shqipërinë e viteve 60-70-të.

⁴³ NARA, File 767, Year 1962, American Embassy, Rome: Memorandum of Conversation, Albanian Exiles Oppose Economic Aid to Hoxha Regime, January 9, 1962, pp. 1-2.

emigracionit politik shqiptar në Itali, krahas mendimeve që shfaqën u dorëzuan gjithashtu autoriteteve diplomatike amerikane edhe një memorandum të posaçëm mbi gjendjen aktuale në Shqipëri dhe krizën shqiptaro-sovjetike. Gjatë bisedës, përfaqësuesit e lartpërmendur shprehën së pari, vendosmërinë e tyre kundër arritjes së paqes së mundshme të Perëndimit me regjimin e Hoxhës. Ata u shprehën gjithashtu edhe kundër dhënies së ndihmave ekonomike për Shqipërinë. Ndihamat për Hoxhën, sipas tyre do të ishin mbështetje për të përjetësuar sundimin e tij në Shqipëri. Ata mendonin se maksimumi që mund të bëhej për Shqipërinë komuniste në këtë kohë, do të ishte dhënia e disa ndihmave të kufizuara, por të shoqëruara me kushte të ashpra, në mënyrë që ato të përdoreshin për të ushqyer popullin dhe jo për të forcuar regjimin. Së dyti, SHBA duhej të ndërhynte dhe të frenonte politikën e Italisë dhe të Francës, në rast se këto të fundit do të vendosnin të avancojnë ndihmat e tyre ekonomike për Shqipërinë. Së treti, ata u munduan të tërhiqnin vëmendjen e Perëndimit në lidhje me karakterin perfid të udhëheqjes komuniste. Sipas tyre, udhëheqja komuniste e Shqipërisë në fillim kishte tradhtuar Titon, tani po tradhtonte Hrushovin, dhe nesër do të tradhtonte Perëndimin, nëse ky do t'i ndihmonte ata. Ali Këlcyra, në dallim nga dy përfaqësuesit e tjerë, Vërlaci e Koliqi, të cilët gëzonin mbështetjen e qeverisë italiane, shprehu rezervat e të mërguarve shqiptarë për “qëndrimin miqësor të qeverisë italiane” ndaj qeverisjes së Hoxhës. Këlcyra pretendonte se, qeveria italiane ishte shprehur e gatshme që të zgjeronte marrëdhëniet tregtare me Shqipërinë dhe se kishte ndaluar propagandën kundër regjimit shqiptar në transmetimet e RAI-it (Kompania Shtetërore Italiane e Transmetimit). Këlcyra mendonte se ky qëndrim i shtetit italian ishte bërë i mundur pas urdhrit të dhënë nga vetë kryeministri i Italisë, Fanfani. Së katërti, tre përfaqësuesit shqiptarë shprehën mendimin e përbashkët se qeveria shqiptare do të binte, në rast se Kina do të ndërpriste ndihmat për Shqipërinë, por sidoqoftë Perëndimi nuk duhej të përsëriste gabimin që kishte bërë me Jugosllavinë, duke e ndihmuar atë. Së fundi, ata mendonin se Shtetet e Bashkuara duhej të hartonin një plan për çlirimin e mundshëm të Shqipërisë. Në zbatim të tij, duhej të ndihmohej dhe të organizohej emigracioni shqiptar jashtë vendit dhe të nxiteshin aktivitetet brenda dhe jashtë Shqipërisë kundër regjimit të Hoxhës. Ekzilatët shqiptarë u shprehën të pakënaqur që tanimë Shtetet e Bashkuara nuk po zhvillonin më propagandë kundër regjimit të Hoxhës.

Konsulli amerikan në Romë do ti përcillte Washingtonit përmbledhtazi idetë e emigrantëve shqiptarë, duke vënë në dukje se ata nuk kishin mbështetës në Shqipëri. Për opinionin e tij, si Këlcyra ashtu edhe Vërlaci përfaqësonin forcat më konservatore brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ndërsa kërkesën e këtyre të fundit për çlirimin e Shqipërisë nga thundra komuniste, ai do ta komentonte si kërkesë që çonte në rifitim të pronave të tyre të humbura në Shqipëri. Ndërsa për Koloqin, diplomati amerikan në Romë do të vinte në dukje se ai kishte qenë mik i qeverisë italiane, përpara dhe pas pushtimit të Shqipërisë⁴⁴.

Situata që po kalonte Shqipëria tërhoqi gjithashtu vëmendjen e Komitetit “Shqipëria e Lirë” me qendër në New York. Më 30 tetor 1962, në emër të tij, Rexhep Krasniqi do t’i drejtonte një letër Zyrës së Çështjeve të Evropës Lindore të Departamentit të Shtetit⁴⁵. Gjendja që po kalonte Shqipëria konsiderohej shumë delikate dhe jo e qëndrueshme. Sidoqoftë ajo gjykohej si e favorshme për të shtuar rezistencën ndaj “qeverisjes së kuqe”. Krasniqi kërkonte nga DSH që ky i fundit të hartonte dhe shpërndante një deklaratë të posaçme mbi Shqipërinë me rastin e 50-vjetorit të pavarësisë së saj. Deklarata do të ndikonte në rritjen e rezistencës antikomuniste të shqiptarëve, në ruajtjen e pavarësisë së vendit dhe paqes në përgjithësi. Kërkesa e Krasniqit synonte të tërhiqte mbështetjen amerikane për Shqipërinë, në rrethanat e vështira që ajo po kalonte dhe të shmangte rreziqet që asaj i kanoseshin. Letra nuk përmendte me emër shtetet armike të Shqipërisë, por i nënkuptonte ato, duke shtuar se, në të shkuarën Shqipëria kishte qenë viktimë e manipulimeve politike.

Politika amerikane ndaj konfliktit shqiptaro-sovjetik u bë objekt diskutimi në takimin e Grupit të Përhershëm të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, të mbajtur më 26 janar 1962. Si bazë për diskutimet shërbeu studimi më i fundit, i përgatitur nga Departamenti i Shtetit me titull: “Vendime të menjëhershme politike të Shteteve të Bashkuara lidhur me

⁴⁴ Po aty, Terry B. Sanders (Counselor of American Embassy, Rome) to Department of State, January 30, 1962, pp.1-2.

⁴⁵ Record of the U.S. Department of State Relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Roll 1, Rexhep Krasniqi (Free Albania Committee) to Harold C. Vedeler, Director Office of Eastern European Affairs, D.C. October 30, 1962, p.1.

Shqipërinë”⁴⁶. Studimi i DSH përfaqësonte deri në këtë kohë formulimin më të gjerë dhe më të plotë për politikën amerikane. Departamenti i Shtetit kërkonte të tërhiqte vëmendjen e Presidentit lidhur me çështjet kryesore që politika amerikane duhej të ndiqte për situatën e krijuar në Shqipëri dhe ndryshimet e politikës shqiptare ndaj asaj që ndiqte BS dhe vendet e tjera satelite të tij. Studimi i DSH gjykohej gjithashtu me vlera të veçanta edhe për vetë NATO-n dhe vendet anëtare të saj, veçanërisht në lidhje me ndjekjen e politikës “larg duart nga Shqipëria”, çështjet tregtare dhe zgjerimin e marrëdhënieve diplomatike të Shqipërisë me vendet e papërfshira në dy blloqet më të mëdha ushtarake të kohës, NATO-n dhe Traktatin e Varshavës.

Dokumenti më i plotë dhe më i rëndësishëm, i titulluar “Shqipëria, udhërrëfyes i politikës dhe operacioneve të Shteteve të Bashkuara” u përfundua në shkurt 1963. Ai mbante siglën e DSH dhe të Sekretarit Amerikan të Shtetit, por për përgatitjen e tij kontribuan edhe agjenci dhe departamente të tjera amerikane⁴⁷. Që në fillim të studimit theksohej qartë pozicionimi i Shteteve të Bashkuara dhe i Perëndimit, ndaj situatës në Shqipëri duke e trajtuar atë thjesht nga interesat e saj dhe të Perëndimit në përgjithësi. Për SHBA Shqipëria ishte një forcë madhore përçarëse brenda bllokut sovjeto-kinez dhe Lëvizjes Komuniste Ndërkombëtare. Politika amerikane duhej të përfitonte sa të mundte nga kriza shqiptare, duke shikuar edhe mundësitë e ndarjes së saj nga Blloku Komunist, ose të ndryshimit të natyrës së regjimit shqiptar⁴⁸.

Studimi përbëhet nga pesë pjesë, të titulluara: trajtimi bazë, sfondi i ngjarjes, objektivat, linjat e veprimit dhe parashikimet për zhvillimet e ardhshme. Në pjesën e titulluar sfondi i ngjarjes janë theksuar tek probleme të tilla, si: së pari, çarja ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik ishte e plotë, por nuk ishte shoqëruar me veprime ekstreme nga vendet e tjera ish komuniste përveç Bashkimit Sovjetik. Sovjetikët kishin kërkuar tërheqjen e plotë të personelit diplomatik shqiptar nga vendi i tyre, ndërsa vende si Polonia, Rumania, dhe Bullgaria i kishin lejuar ambasadorët e Shqipërisë dhe personelin diplomatik të qëndronin në

⁴⁶ Po aty, File 767, Year 1962, Memorandum, L. D. Battle-Executive Secretary to for Robert Amory – Central Intelligence Agency, Subject: NSC Standing Group, January 25, 1962, p.1.

⁴⁷ NARA, RG 59, Albania, Department of State, Guidelines for Policy and Operations, February 1963, pp.1-20.

⁴⁸ Po aty.

vendet e tyre. Vendet e tjera të Bllokut e kishin zbritur nivelin e përfaqësimit me Shqipërinë në nivel të ngarkuarish, duke i larguar ambasadorët e Shqipërisë nga vendet e tyre. Së dyti. Marrëdhëniet tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve anëtare të Bllokut (përveç Bashkimit Sovjetik) vazhduan të funksiononin, por vëllimi i tyre ra së tepërmi. Këto vende u dhanë fund kredive, ndihmave teknike dhe vizitave kulturore me Shqipërinë. Së treti, Shqipëria vazhdonte të mbetej zyrtarisht një vend anëtar i Traktatit të Varshavës dhe i Këshilli Ekonomik të Ndihmës Reciproke (KNER), ndonëse ajo nuk ishte ftuar të merrte pjesë në dy organizmat e mësipërme. Së katërti, regjimi shqiptar i kishte sfiduar sovjetikët dhe kishte fituar pavarësinë nga kontrolli i Moskës, ndërsa situata dukej deri diku e ngjashme me atë të prishjes së Jugosllavisë me BS në vitin 1948. Bashkimi Sovjetik nuk ishte pajtuar me sfidën e shqiptarëve dhe dëshironte të hiqte nga postet drejtuesit kryesorë të PPSH dhe ushtronte mbi Shqipërinë presion të fortë ekonomik dhe politik. Ky presion mbi Shqipërinë dukej i përballueshëm prej kësaj të fundit. Së pesti, Shqipëria nuk e kishte ndryshuar armiqësinë e saj të fortë ndaj Shteteve të Bashkuara dhe botës së lirë, ndonëse kishte treguar interes për të zgjeruar lidhjet me vendet e pa anëtarësuar në blloqe. Për këtë hap të saj flisnin kontaktet për të vendosur marrëdhënie diplomatike me Holandën, Suedinë, Libinë, Marokun dhe Burmën, vendosja e tyre me Austrinë dhe Irakun dhe manifestimi i interesave të saj për marrëdhënie më të mira me vendet fqinje, si Italia dhe Greqia. Udhëheqja shqiptare përmes gazetës “Zëri i Popullit” ishte shprehur për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, tregtare dhe kulturore me “të gjitha vendet kapitaliste”. Ajo vazhdonte të kërkonte miqësinë e popullit sovjetik, të fliste për dallimet e saj me udhëheqjen sovjetike dhe njëkohësisht të tregonte besnikërinë e saj për vijën socialiste. Së gjashti, Kina do të ishte faktor i rëndësishëm në mbështetjen e saj ekonomike dhe politike ndaj Shqipërisë, por ajo nuk gjykohej si plotësisht e mjaftueshme për Shqipërinë. Si rezultat, mendohej se Shqipëria do të vazhdonte të kërkonte të forconte pozitën e saj ndërkombëtare përmes shtimit të tregtisë dhe vendosjes së marrëdhënieve të mëtejshme diplomatike me vendet e papërfshira në blloqe. Kjo situatë mund t’i lejonte SHBA dhe aleatët e saj që të shtonin influencën e tyre në zhvillimet e ardhshme në Shqipëri. Por, derisa pozita e Shqipërisë mbetej fluide, nënvizohej në studim, politika jonë duhet të jetë elastike dhe subjekt për t’u përshtatur ndryshimeve të ardhshme. Për këtë arsye vazhdohej më tej, vija jonë

politike në tre vitet e ardhshme mund të kërkojë modifikime dhe kursi i veprimeve do të varet nga zhvillimet e ardhshme. Së shtati, në studim i kushtoj vëmendje mundësisë së rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë por këtij akti duhet t'i paraprinte hapja e ndonjë linje komunikimi me shqiptarët dhe pastaj do të vazhdohej më tej të negociohej mbi kushtet e njohjes së qeverisë shqiptare dhe për hapat e mëtejshme që do të ndërmerre Misioni i Shteteve të Bashkuara në Shqipëri.

Studimi i mësipërm përcaktonte gjithashtu objektivat e Shteteve të Bashkuara mbi Shqipërinë. Shtetet e Bashkuara do të ndiqnin politikën "larg duart" nga Shqipëria, duke ruajtur dhe mbështetur politikën e tyre për Shqipërinë si "pykë" ndërmjet Kinës dhe BS, duke mbështetur marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet jo anëtare të blloqeve të mëdha, duke ruajtur pavarësinë e saj dhe politikën e mosndërhyrjes së fqinjëve, duke vazhduar të bëjë më tej publike natyrën e komunizmit shqiptar dhe armiqësive të tij ndaj Shteteve të Bashkuara. Ato do të shmangnin veprimet që dobësonin rolin e Shqipërisë si faktor përçarës në botën komuniste. SHBA gjithashtu do të vazhdonin të ishin neutrale ndaj palëve në konflikt dhe nuk do të merrnin ndonjë iniciativë që do të sillte si pasojë bashkëveprimin e sovjetikëve me kinezët në mbrojtje të Shqipërisë. Pra ata nuk do të luanin rolin e çlirimtarit në rrethanat e Luftës së Ftohtë. Po kështu ato nuk do të kërkonin ta ndryshonin regjimin shqiptar dhe as të përkrahnin qëndrimin e tij të tanishëm. Politika e SHBA do të nxiste ndihmën e Perëndimit ndaj Shqipërisë për të shmangur fatkeqësitë nëse Kina nuk do të ishte në gjendje të ndihmonte atë. Marrëdhëniet tregtare me Shqipërinë do t'u nënshtroheshin të njëjtës logjikë veprimi që ndiqej me vendet e tjera komuniste të Evropës Lindore, duke përjashtuar Poloninë. Sidoqoftë politika e SHBA ndaj Shqipërisë në të ardhmen parashikohej të ishte më e moderuar dhe më e përmbajtur se më parë. Amerikanët nuk dëshironin që Shqipëria të bëhej mollë sherri për fqinjët. Por sidoqoftë ata shpreheshin të gatshëm të komunikonin me qeveritë greke, italiane e jugosllave, duke u bërë të qartë se SHBA dëshironin një zonë të qëndrueshme në Adriatik, dëshironin të ruanin stabilitetin në rajon dhe të zbatonin politikën "larg duart" nga Shqipëria. SHBA pranonin të merrnin iniciativën për të koordinuar politikat e tyre me ato të vendeve të tjera anëtare të NATO-s, të cilat mund të çonin në vendosjen e marrëdhënieve diplomatike dhe tregtare me Shqipërinë.

Politika e mësipërme e SHBA përgjithësisht u hartua duke pasur në konsideratë zhvillimet aktuale në Shqipëri. Por në pjesën e fundit të studimit i kushtohej vëmendje kundërveprimit të amerikanëve, nëse rrjedha e ngjarjeve në Shqipëri merrte kurs tjetër zhvillimi. Studimi analizonte tre situata të ndryshme që mund të krijoheshin në Shqipëri në të ardhmen. Rasti i parë i kushtohej mundësisë së futjes së Shqipërisë sërish nën ombrellën sovjetike. Parashikimi i dytë nënkuptonte tërheqjen e mbështetjes kineze dhe i fundit, trajtonte situatën kur regjimi i tanishëm do të fitonte pavarësinë kombëtare të vendit të vet dhe do të siguronte mbështetjen e Perëndimit.

Precedenti i parë mund të ndodhte nëse sovjetikët do ta detyronin regjimin e Hoxhës të kapitullonte, duke imponuar zëvendësimin apo spastrimin e udhëheqjes së lartë shqiptare. Kjo situatë mund të krijohej nga sovjetikët dhe aleatët e tyre, duke përdorur kryesisht rrugët dhe mjetet diplomatike, ekonomike, ideologjike dhe presionin partiak. Ndërhyrja e armatosur kundër Shqipërisë, duke përdorur territorin jugosllav apo duke kryer zbakime ajrore apo detare, shihej në të vërtetë si alternativë që kishte pak gjasa të ndodhte, sepse nëse ndërmerrej ajo do të sillte pasoja për vetë autoritetin e BS, do të prishte balancat dhe do të rrezikonte edhe Jugosllavinë. Sidoqoftë, nëse ndodhte ndonjë aksion sovjetik kundër Shqipërisë, Shtetet e Bashkuara do të ishin të detyruara të përballeshin me marrjen e një vendimi politik të një rëndësie të veçantë, i cili do ta ndalonte rënien e Shqipërisë sërish nën dominimin sovjetik. Kundërveprimi amerikan, natyra e të cilit nuk specifikohet në dokument, do të ndërmerrej për dy arsye kryesore: së pari, sepse do të humbiste karakteri përçarës i Shqipërisë brenda Bllokut Komunist, dhe së dyti, do të dekurajonte dhe frenonte vendet socialiste të Evropës Lindore, që të ndërmerrnin ndonjë revoltë, e cila do të synonte pavarësinë e tyre nga sundimi sovjetik. Plogështia dhe mosveprimi i Perëndimit dhe SHBA si lidhshmëri i tij, do të përcillte imazhin e pafuqisë tek popujt e vendeve socialiste por edhe tek lëvizjet e tjera emancipuese në botë.

Tërheqja e mbështetjes ekonomike, politike dhe ideologjike të Kinës për Shqipërinë gjithashtu do të krijonte një situatë shumë të veçantë për Perëndimin. Ripajtimi sovjeto-kinez mund të ndodhte për arsye të tilla të supozuara si: afrimi i pozicionit të tyre politik dhe ideologjik ose zbutja e diferencave të tyre për problemet konfliktuale. Por tërheqja e ndihmës kineze mund të vinte edhe për shkak të humbjes së interesit të Kinës për Shqipërinë, nëse kjo e fundit do të dëshironte të

kishte një shtet tërësisht të pavarur nga Kina. Nëse ndodhte kështu, Shqipëria do të ndodhej nën presionin e fortë të vendeve socialiste të Evropës dhe ajo do të shkonte drejt një izolimi të plotë dhe të rrezikshëm. Në rastin kur Shqipëria do të vazhdonte të ishte shtet rebel kundër sovjetikëve, amerikanët dhe Perëndimi do të mbështesnin regjimin e tanishëm të Shqipërisë, por me kushtin që ai të zbatonte në vend modelin jugosllav. Por në studim analizohej edhe varianti tjetër, i cili mund të çonte në rrëzimin e regjimit të Hoxhës si rezultat i revoltave të brendshme, që do të ndodhnin për shkak të tërheqjes së mbështetjes kineze për Shqipërinë. Alternativa e fundit do të kërkonte marrjen e vendimeve të posaçme nga Perëndimi dhe SHBA, por gjithnjë duke marrë në konsideratë marrëdhëniet kino-sovjetike, sovjeto-amerikane dhe interesat e fqinjëve të Shqipërisë. Sipas kësaj logjike çështja shqiptare me enigmat që ajo fshihte, nuk ishte thjesht një problem i brendshëm i shqiptarëve, por ajo do të shoqërohej me efekte në politikën rajonale e më gjerë. Pra ajo ishte pjesë e zhvillimeve dhe skemave të Luftës së Ftohtë, e cila i kufizonte shumë ndryshimet që mund të ndodhnin në territoret e dy blloqeve kundërshtarë, që siç kishin treguar zhvillimet e mëparshme në Hungari e gjetkë i kishin bërë të paefektshme përpjekjet e palëve kundërshtarë për “kalimin e gardhit” edhe kur popujt e Evropës Lindore dëshironin të dilnin nga tutela sovjetike.

Rasti i fundit, supozonte ekzistencën e një shteti shqiptar sipas konceptit të Perëndimit, të pavarur dhe të mbështetur prej tij. Pranimi i evoluimit të regjimit të tanishëm në shtigjet e vlerave perëndimore shihej si një fenomen që ndonëse kishte pak gjasa të arrihej nuk hidhej poshtë plotësisht. Në këtë konkluzion arrihej kur analizoheshin zhvillimet e Shqipërisë pas LDB dhe pikërisht dy tregues të saj, faktit që sigurimi i mbështetjes ekonomike për vendin kishte qenë dhe vazhdonte të ishte një kusht esencial për Shqipërinë. Po kështu, shkalla e varësisë së Shqipërisë ndaj vendeve ish-tutore si Jugosllavia dhe BS, tanimë edhe nga Kina kishte ardhur duke u pakësuar, për shkak të largësisë në rritje të distancës nga këto vende. Tentativat e Shqipërisë për të zgjeruar marrëdhëniet e saj me vendet e paangazhuara, shiheshin si tregues që mund t’u paraprinin zhvillimeve të ardhshme të pafavorshme, që mund të ndodhnin në marrëdhëniet me Kinën. Sidoqoftë, Perëndimi do të kërkonte me ngulm që Shqipëria të ishte një shtet plotësisht i pavarur nga të tjerët. Politika amerikane ndaj këtij precedenti do të heshte në konsideratë edhe pikëpamjet e vendeve fqinje të Shqipërisë, të miqve dhe aleatëve

perëndimorë, ndikimin pozitiv që mund të ushtronin ato mbi marrëdhëniet e SHBA, por edhe me sovjetikët, kinezët dhe me vendet socialiste të Evropës. Kjo politikë do të ndikonte dhe nxiste kërkesat e këtyre të fundit, për t'u çliruar nga sundimi sovjetik dhe për të rifituar pavarësinë kombëtare të tyre.

Asnjë nga parashikimet e mësipërme nuk ndodhi. Shqipëria mbeti një vend tipik stalinist i ankoruar edhe për gati dy dhjetëvjeçarë të tjerë pas Kinës komuniste. Sidoqoftë, ajo e “përligji” rolin e saj si faktor përçarës brenda botës komuniste. Ndarjet e Shqipërisë me Jugosllavinë në 1948, me BS në vitin 1961 dhe me Kinën në vitin 1978, janë fenomene të cilat kanë tiparet e tyre të përbashkëta dhe të veçanta. Parë në kontekstin e interesave tona kombëtare, ndarjen me Jugosllavinë, do ta konsideronim një akt pozitiv në tërësinë e vet. Sidoqoftë, tre ndarjet e mëdha të Shqipërisë me ish-vendet socialiste gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë kanë si karakteristikë të përbashkët ndjekjen e politikave më të hapura dhe më liberale brenda vendeve të tyre dhe në marrëdhënie me Perëndimin. Ky fenomen nuk ndodhi në Shqipërinë e pasluftës.

S u m m a r y

THE WESTERN POLITICS TOWARDS ALBANIA DURING THE ALBANIAN – SOVIET CRISIS

The article “The Western Politics towards Albania during the Albanian – Soviet Crisis” deals with one of the most difficult and delicate times in the history of Albania. Albania’s detachment from USSR and the rest of the countries of the Communist bloc marked one more cleavage inside the camp of the communist countries, weakening its unity even more. The Albanian – Soviet separation was accompanied by discussions, polemics and quarrels. Furthermore, it attracted the attention of the western countries, especially of the USA and its politics. The United States, as a leader state of the democratic countries, would play a fundamental role in the definition and the formation of the position to keep towards the Albanian – Soviet crisis and would powerfully influence the politics of the other allied countries. The American politics attentively followed the Albanian – Soviet crisis, and tried to take advantage of it. The Stalinist nature of the Albanian regime and the identification of an ally on the Communist China and Mao Zedong, led the West to see Albania as a disruptive factor inside the Communist bloc, especially for the rapports between China and the USSR.

Having good knowledge on the politics and the claims of the neighbors towards Albania, the American politics became a processor of the motto “take your hands off

Albania". The particularities of the Albanian – Soviet crisis and the outlying interests of the USA on the Albanian matters made the Americans treat this case differently from the Soviet – Yugoslavian conflict of 1948. The Albanian Communist leadership never considered its orientation towards the western democratic countries a serious alternative. It simply made surveys on the re-establishment of the diplomatic relations with the United States and Great Britain, until the consolidation its strong rapports with the Popular Republic of China.

This article was edited, principally based on the documentation found in the American and British archives, as well as in the Albanian documentary sources.